



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 167/5 prot

Datë 04.03.2026

V E N D I M

Nr. 341/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me Nipt L52122014L,
Adresa: Rr. “Siri Kodra”, ish-Blloku Magazinat, Tiranë.

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK,
me Nipt. J72124001N, *Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga “Iliria”, nr. 53, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Albpetrol SH.A.
Adresa: Selia Rruga Fier–Patos, km 7.

Subjekt i Interesuar

Operatori ekonomik "SECURITY SYSTEM LIÇAJ" SHPK,
me Nipt K83018403B, Adresa: Lagjja "Liri Gero", Rr. "Haxhi
Kelmendi", Nr.10, Fier.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet të ngritura në ankesë, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*", me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt "*Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune*", me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol Sh.A.

II.2. Në datë 30.12.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se në datën 12.01.2026, është kryer klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

“RAMA - GRAF” SHPK	me ofertë	836,600 Lekë pa TVSh	Skualifikuar
“Inpress” SHPK		955,400	Skualifikuar
“InfoSoft Office” SHPK		997,100	Skualifikuar
“SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK		1,103,400	Kualifikuar
“MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK		1,103,500	Skualifikuar
“IT Gjergji Kompjuter” SHPK		1,248,267.50	Skualifikuar
“F&O COMPANY” SHPK		1,299,850	Skualifikuar
“KRISTALINA.KH” SHPK	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar

II.4. Në datën 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6260, datë 20.01.2026 dhe me Nr. 167/2026 Prot., datë 20.01.2026 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 167/1 prot., datë 21.01.2026, lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. Nr.396/3 prot., datë 28.01.2026, protokolluar me tonën me Nr. 167/2, datë 30.01.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimin me Nr. 396/2 Prot, datë 28.01.2026 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është dorëzuar ankesa me numër aplikimi A/2026/6266, datë 22.01.2026 dhe me nr. 188/2026 prot., datë 22.01.2026 i operatorit ekonomik

“Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK nga procedura e prokurimit sipërcituar, si edhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 188/1 prot., datë 22.01.2026, lidhur me pretendimet e ankimuesit.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. Nr.406/3 prot., datë 28.01.2026, protokolluar me tonën me Nr. 188/2, datë 30.01.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimin me Nr. 406/2 Prot, datë 28.01.2026 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

II.11. Komisioni me shkresën me Nr.188/3 Prot, datë 04.02.2026, me objekt: *Kërkesë për dorëzimin e mostrave dhe informacion shoqërues*, kërkoi nga Autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...]me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë: mostra objekt skualifikimi paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, Konkretisht për “Artikulli nr.6 “Kartela Mjekësore për punonjësit”, si edhe
mostrat objekt i pretendimeve ngritur në ankesë për mospërmbyshje të specifikimeve teknike nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, si vijon:

Mostrat e operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK

Art.	Emërtimi
1	Bllok hyrje ne magazine
2	Bllok dalje ne magazine
5	Kartele magazine me logo
6	Kartela mjekësore

Mostrat të shoqërohen së bashku me:

1. Dokumentacionin shoqërues si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre për të gjitha mostrat e dorëzuara si edhe
2. Dokumentacion mbi vlerësimin e kryer në përmbushje të specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara objekt ankimi.

II.12. Me shkresën Nr. 696/1, datë 05.02.2026, protokolluar me tonën me Nr. 188/4, datë 09.02.2026 me objekt “Dërgim informacioni dhe dorëzim mostra”, në lidhje me ankesën e

operatorit “Marketing & Distribution” SHPK, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit mostrat e kërkuara dhe dokumente në lidhje me administrimin e tyre.

II.13. Me shkresën me Nr.188/5 Prot., datw 18.02.2026, me objekt: *Kërkesë për dërgim dokumentacioni*, kërkoi nga Autoriteti kontraktor në mënyrë të përmblodhur si vijon:

[...] me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë: 1. Dokumentacionin provues të ofertës së operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK i renditur i pari nga AK. Në përputhje me nenin 26/6 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ... Autoriteti Kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, kopje të njehsuara me origjinalin të dokumentacionit të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK. [...]

II.14. Me shkresën Nr. 1315/1 prot., datë 23.02.2026, protokolluar me tonën me Nr. 188/6, datë 25.02.2026, Autoriteti kontraktor ka përcjellë dokumentacionin provues të ofertës së operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK.

II.15. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimeve administrative, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton se në sistemin e ankesave elektronike nuk janë dorëzuar argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar për procedurën objekt shqyrtimi,

III

Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit për mostra e paraqitura prej tij, si vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin 2.3.2 të pikes 2.3 Kapaciteti teknik ne DST, ne lidhje me mostrat e artikujve objekt prokurimi te kerkuara konkretisht:

Artikulli nr.6 “Kartela Mjekësore për punonjësit” nuk është paraqitur sipas standarteve te duhura zyrtare.

Mostra e paraqitur per kete artikull permban shenime ne pjesen e brendshme dhe te jashtme te kopertines, kjo ne kundërshtim me ligjin 124-2024 ku citohet se nuk lejohen shënime mjekësore në vende të ekspozuara (kopertina, pjesë të jashtme, zona joformale).

Operatori pretendon: [...]Ne kemi sjellë mostrën për të treguar tipologjinë e kartelës mjekësore për punonjësit, e cila përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga AK, së dyti disponibilitin dhe ekzistencën e këtij artikulli në fondin e kompanisë tonë. Mostra dorëzohet për të treguar cilësitë e produktit të kërkuara sipas specifikimeve tuaja dhe mundësitë reale që ofertuesi ka për të paraqitur në magazinën e AK. Gjithashtu sqarojmë se në lidhje me artikullin e lartpërmendur

të dorëzuar nga ana e jonë argumentojmë se është treguar disponibiliteti që ne si ofertues e kemi këtë artikull dhe e tregtojmë si dhe jemi të gatshëm që në rast se shpallemi fitues ta depozitojmë në magazinën e AK pavarësisht se institucioni nuk e ka parashikuar në asnjë kornizë të DT që kjo mostër të mos ketë shënime në pjesën e brendshme dhe të jashtme të kopertinës. [...]

III.1.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST Shtojcat 6, Specifikimet Teknike dhe Shtojca 8, Formulari i Kriteve për kualifikim, Kriteri 2.3.2,

Shtojca 6. Artikulli objekt Skualifikimi me të dhëna si vijon:

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Artikulli nr. 6. Kartela Mjekësore për punonjësit

- Sasia – 1,000 copë
- Specifikimet;
 - Formati: Të jetë e lidhur si libër, letër A4, në orientim portrait dhe me ngjyrë të bardhë
 - Kopertina: Karton në formatin e letrës A4, prej materiali letre cilësore, me përmasa 21x29.7 cm dhe peshë 160 g dhe me ngjyrë të bardhë.
 - Me logo të Albpetrol me ngjyra në kopertinë dhe në çdo fletë.



6 - KARTELE
MJEKESORE.pdf

- Model:

-Referuar dokumentit Pdf Kartela Mjekësore, përmban 12 faqe me shkrime dhe tabela sipas modelit dhe formatit të përcaktuar nga AK për mostrën Kartelë Mjekësore.

Shtojca 8.

Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër (1 copë) për zërat me numër rendor 1, 2, 4, 5, 6, 7, sipas shtojcës 7, tabelës së sasive.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në zyrën e protokoll arkivës të Albpetrol sha Patos me seli në rrugën Fier-Patos km 7, së bashku me një dokument për paraqitje mostre të protokolluar në Albpetrol sha, përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, në mënyrë që të jenë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Mostrat do të jenë kofidenciale për secilin Operator Ekonomik dhe do t'i kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës me paraqitjen e një kërkesë pranë AK nga ana e OE ofertues.

III.1.2. Autoriteti kontraktor ka shqyrtuar ankesën dhe me Vendimin e KSHA-së ka argumentuar qëndrimin kundër në mënyrë të përmbledhur si vijon: [...]

Mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë nuk përputhen me modelin dhe specifikimet teknike të kartelës mjekësore të punonjësve, siç janë përcaktuar në dokumentet e tenderit ku kërkohet :
Formati: Të jetë e lidhur si libër, letër A4, në orientim portrait dhe me ngjyrë të bardhë
Kopertina: Karton në formatin e letres A4, prej materiali letre cilësore, me përmasa 21x29.7 cm dhe peshë 160 g dhe me ngjyrë të bardhë.
Me logo të Albpetrol me ngjyra në kopertinë dhe në cdo fletë

Specifikimet teknike të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor përcaktojnë modelin e kartelës mjekësore, përfshirë kopertinë, dhe kërkojnë që përmbajtja mjekësore të mos ekspozohet në elementë të jashtëm të dukshëm, në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe minimizimit të të dhënave të Ligjit 124/2024. Në praktikën e administratës publike, dokumentet apo materialet e printuara (si kartelat mjekësore, raporte, formularë, blloqe pune, dosje zyrtare) në kopertinë evidentojnë:
kopertinë minimaliste me elemente identifikuese (logo, emër, kodi i artikullit, etj.);
pa përmbajtje të panevojshme ose tekste që nuk kanë funksion identifikimi;
përdorim të njëanshëm të kopertinës për identifikim, jo për përshkrime apo mesazhe të gjata.

Për këtë arsye, skualifikimi i operatorëve është i bazuar në mospërputhjen materiale me specifikimet teknike të DST-së, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar, sipas Legjislacionit të prokurimit. Ligji 124/2024 ka ndikim në përcaktimin e kërkesave të autorizuara për trajtimin e të dhënave sensitive, duke përfshirë të dhënat mjekësore të punonjësve.
Printimi i përmbajtjes në faqet e brendshme dhe të pasme të kopertinës përbën devijim nga modeli dhe specifikimet teknike.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë pikë të ankesës nuk qëndron.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat mallrave” pikat 5 dhe 8, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqitin mostra në përmbushje të kriterit 2.3.2, dhe në referim të arsyes së skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë institucionit tonë, mostrat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi sipas shtojcës 7, tabelës së artikujve, e konkretisht mostra objekt skualifikimi **Artikulli nr. 6. Kartela Mjekësore për punonjësit e operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK**, si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre të cilat autoriteti kontraktor i ka përcjellë pranë Komisionit, (cituat më sipër).

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqitin pranë AK-së mostra për disa nga artikujt sipas shtojcës 7.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të ankimuesit: *Artikulli nr.6 “Kartela Mjekësore për punonjësit” nuk është paraqitur sipas standarteve të duhura zyrtare. Mostra e paraqitur për këtë artikull përmban shënime në pjesën e brendshme dhe të jashtme të kopertinës, kjo në kundërshtim me ligjin 124-2024 ku citohet se nuk lejohen shënime mjekësore në vende të ekspozuara (kopertina, pjesë të jashtme, zona joformale)*, Komision nga shqyrtimi i mostrës së dorëzuar të operatorit ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit si edhe i shtojcave 6 dhe 7 të DST, Konstatoi se Modeli i paraqitur nga AK përmban 12 faqe me shkrime dhe tabela sipas përcaktimeve të AK-së dhe krahasuar me Mostrën objekt shqyrtimi rezultoi se Mostra ka të njëjtën përmbajtje në tërësinë e saj me Modelin e kërkuar duke rezultuar identike.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon se Arsyeja e skualifikimit nuk ka të bëjë me mospërputhje të specifikimeve teknike të vendosura nga vetë Autoriteti kontraktor me shtojcën 6 dhe Modelin respektiv. Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK nuk qëndron.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, për mospërmbushje të kriteret si vijon:

1. Nuk ka plotësuar Shtojcën 9, FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT,

“Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: Deklarata për përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit”. Me argumente :

- Në lidhje me shtojcën e mësipërme konkretisht **“Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: Deklarata për përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit”** pretendojmë që ofertuesi “Security System Licaj” nuk ka mbushur në mënyrë të saktë të gjithë, komplet deklaratën e lartpërmendur duke mospërcaktuar në mënyrë të saktë çdo dokument që do të dorëzohet në përmbushje të rubrikave të kësaj deklarate si dhe institucionin që do lëshojë dokumentin përkatës. Mosmbushja në mënyrë të saktë e deklaratës së mësipërme nga ana e ofertuesit të lartpërmendur është kusht për skualifikimin e tij nga procedura. ...
- Gjithashtu pretendojmë se ofertuesi i lartpërmendur, që në zbatim të Nenit 26, pika 6 e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar) ku kishte për detyrë që në përmbushje të paragrafit:

“Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____”,

nuk ka paraqitur asnjë dokument që verteton se ky subjekt nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale dokument i cili merret sipas ligjit pranë Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në DST ka publikuar

Shtojcën 8, [Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

AK ka publikuar në SPE “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, **Pjesa II-** objekt-ankimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” ShPK ka dorëzuar dokumentin emërtuar:



8_Formular_Vetëdeklarimi_SSL_shpk.pdf

Në brendi të të cilit konstatohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i plotësuar, i firmosur dhe i vulosur në të gjitha faqet.

III.2.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:
- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
 - b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;
 - c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi;
 - ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
 - d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;
 - e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.
 - ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
 - f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.
 - g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar, kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
 - gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
 - h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.
4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.
5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.2.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.5. Në nenin 26 **“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”**, pikat 1, 2, 3, dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, **ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;**

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. **Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij .** Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e dorëzuara, pjesë e ofertës në SPE e operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, dhe konstatoi se ka depozituar Dokumentin emërtuar: **Formular_Vetëdeklarimi_SSL_shpk.pdf**, në brendi të të cilit gjendet, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit në përputhje në formë me Formularin e publikuar në DST, i plotësuar me të dhëna në të gjitha nëndarjet e Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT.

III.2.6. Në referim të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimuesit, Komisioni mori në shqyrtim dokumentin Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga ku rezultoi se operatori ekonomik ka dhënë informacion të plotë në tërësi të tij dhe në veçanti në pjesën objekt ankimi: Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT. Referuar dokumentit konstatohet se operatori ekonomik ka plotësuar informacionin e kërkuar në të gjitha nëndarjet e **Pjesës II**, duke deklaruar të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara, siç ky formular parashikon në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të cilat do të quhen të përmbushura me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

III.2.7. Me qëllim të kryerjes së një procesi të rregullt dhe të paanshënm mbi trajtimin e ankesës, mbi pretendimet për paraqitje të dokumentit: *se ky subjekt nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale*, Komisioni, me shkresën me Nr.188/5 Prot., datë 18.02.2026, me objekt: *Kërkesë për dërgim dokumentacioni*, kërkoi nga Autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbledhur si vijon: [...] me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë: 1. Dokumentacionin provues të ofertës së operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK i renditur i pari nga AK...[...]

Autoriteti kontraktor, në përgjigje të shkresës sipërcituar, përcolli pranë KPP-së Informacionin e kërkuar në formë shkresore, kopje të dokumenteve të operatorit ekonomik, si vijon:

1. Shtojca 9, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i plotësuar, i firmosur dhe i vulosur.
2. Shtojca 1, Formulari i Ofertës Ekonomike, dt. 30.12.2025, i plotësuar, me firmë e vulë.
3. Dokumenti, Polica e Sigurimit të Ofertës, lëshuar nga Shoqëri Sigurimi, me datë 29.12.2025
4. Ekstrakti Histori i Regjistrat Tregtar.
5. Vërtetim Për xhiro e tre viteve të fundit. Dt. 02.12.2025
6. Vërtetim Për pagim detyrime deri me datë **15.01.2026** nga Dr. Përgj, e Tatimeve.
7. Vërtetim Për Statusin Aktiv/Pasiv/Të tjera, me datë **15.01.2026** nga Dr. Përgj, e Tatimeve.
8. Kthim përgjigje për tatimpaguesin “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, Nuk ka Detyrime në Tatim mbi Vlerën e Shtuar, në Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës, në Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëdetësore dhe Tatim mbi të ardhurat nga Punësimi, në Tatim i Mbajtur në Burim., lëshuar nga Dr. e Shërbimit të Tatimpaguesve.
9. Fatura mbi punë të ngjashme
10. **Vërtetim nga Sektori i Gjendjes Civile, për Subjektin “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, rezulton i padënuar, lëshuar me datë 15.01.2026.**
11. Vërtetim Debie lëshuar nga FSHU OSHEE, për Klientin “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, Nuk rezulton Debitor , lëshuar me dt.**15.01.2026**.
12. Vërtetim lëshuar nga Bashkia Fier, për Subjektin “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2025, lëshuar dt. 11.12.2025.

13. Certifikatë AQS/Q/156882025, Është në përputhje me standardin ISO 9001:2015 për aktivitetin e tij.
14. Kontratë shërbimi mbi Licencën e-Bills dhe suport.
15. Certifikatë Rejistrimi lëshuar nga QKB, për Personin e tatueshëm “SECURITY SYSTEM LICAJ”, Status Aktiv.

Referuar, bazës ligjore, neni 26/6 i VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Deklarimeve të Shtojcës 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit si edhe Dokumentacionit provues të operatorit ekonomik, dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit, rezulton se operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK nuk ka përcjellë pranë Autoritetit Kontraktor dokumente të rregullta provuese, të cilat i ka deklaruar me shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

Konkretisht, Vërtetim nga Sektori i Gjendjes Civile, për Subjektin “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, rezulton i padënuar, lëshuar me datë 15.01.2026, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentin, i cili rezulton i vulosur elektronikisht i lëshur përtej datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, e cila ka qenë 30.12.2025, duke rezultuar dy javë pas hapjes së ofertave, jo sipas parashikimeve në nenin 26/6 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, [..]dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij .[...]

Referuar parashikimeve më sipër të aktit rregullator dokumentet provues të deklaruar në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të provojnë gjendjen faktike të subjektit në momentin e ofertimit, pra deri më datë 30.12.2025, datë në të cilën janë hapur për vlerësim ofertat. Nga verifikimet e dokumenteve provuese të cilët janë deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe të dorëzuara në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK si i kualifikuar i pari rezulton, se dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar që provon deklarimet e bëra për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim (dokumentacion i listuar më sipër në këtë vendim) rezulton se mban datën 15.01.2026 (jo vetëm dokumenti objekt ankim).

Në këtë kuadër Komisioni konstaton, se lidhur me dokumentacionin provues për deklarimin e bërë nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK në shtojcën 9, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, Pika A “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” nuk është i vlefshëm për përmbushjen e deklarimeve të bëra përpara hapjes së procedurës, këto dokumenta nuk ishin lëshuar akoma nga organet kompetente në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk mund të provohen me dokumentacion që nuk ka ekzistuar në këtë datë, pra në datë e hapjes së ofertave.

KPP gjykon, se operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve me datë lëshimi *para hapjes së ofertave* dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumentacionin e cituar më sipër në këtë vendim (dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik i ndryshuar) me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se data 30.12.2025. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cënonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili sigurohet pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.”

Në një procedurë prokurimi operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura nga autoriteti kontraktor.

Për sa referuar më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni provuese i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, i datës 15.01.2026 i paraqitur nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” SHPK, si prove e deklarimeve të bëra në formularin përmbeldhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim duke qenë se ka datë të mëvonshme nga data e hapjes së ofertave (me 30.12.2025) nuk provon gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore e rregullatore në fuqi për prokurimin publik dhe si rrjedhim nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK, për mospërmbushje të kriterit 2.3.1 nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LICAJ” ShPK me argumentet si vijon:

2. Kriterin 2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, **si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**

[...] Në lidhje me kriterin e lartpërmendur, pretendojmë që ky ofertues nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Pretendimin tonë e bazojmë në faktin që kompania jonë, si ndër dy kompanitë më të mëdha në fushën e kancelarisë, letrës dhe shtypshkrimeve, ky ofertues nuk ka shitje të shtypshkrimeve, produkt i kërkuar nga AK në preventivin e dokumenteve standarte të tenderit. Duke qenë se ky subjekt është i padëgjues në fushën e shtypshkrimeve mundësia që ky operator të ketë paraqitur, në sistemin elektronik të prokurimeve nuk ka asnjë kontratë/vertetim të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore shitje që të vertetojnë faktin që ky subjekt krijon bindjen për ekzekutimin e kontratës sipas kushteve dhe parametrave të kërkuar.[...]

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 8, Formulari i Kritereve të Përzgjedhje/Kualifikimit. **2.3 Kapaciteti teknik: Kriterin 2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vertetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.3.2. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si **dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

III.3.3. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.3.4. Operatori ekonomik ka paraqitur si pjesë të ofertës së tij në përmbushje të kriterit kualifikues 2.3.1. mbi kontrata të ngjashme, dokumentet si vijon:

1. Dokumenti 1.1 Fatura të ngjashme, Faturë elektronike Nr. 133/2025, date 18.11.2025 shitës - "SECURITY SYSTEM LIÇAJ" ShPK, për mallrat: Shtypshkrime, fotokopje, printime me vlerë Total XXX,XXX L. pa TVSH.

2. Dokumenti 1.2 Fatura të ngjashme, Faturë Tatimore Nr. 125/2025, date 15.11.2025 shitës - "SECURITY SYSTEM LIÇAJ" ShPK për mallrat: Shtypshkrime, fotokopje, printime me vlerë Total XXX,XXX L. pa TVSH.

3. Dokumenti 1.3 Fatura të ngjashme, Faturë elektronike Nr. 77/2024, date 07.10.2024 shitës - "SECURITY SYSTEM LIÇAJ" ShPK. për mallrat: Aksesorë të Brendshëm, me vlerë Total XX,XXX L. pa TVSH.

4. Dokumenti 1.4 Fatura të ngjashme, Faturë elektronike Nr. 38/2025, date 05.05.2025 shitës - "SECURITY SYSTEM LIÇAJ" ShPK me vlerë Total XX,XXX L. pa TVSH.

III.3.5. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit

kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin: **2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Referuar dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, në SPE, por edhe dokumentave provuese të përcjella nga AK, Komisioni pasi i mori në shqyrtim dhe në analizë të gjitha faturat tatimore shitjeje me subjekte private, konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar në SPE si edhe në formë shkresore është në përmbushje të kriterit kualifikues, operatori ekonomik **ka paraqitur fatura 1_1 dhe 1_2 shitje me sektorin privat ku 2 nga faturat përmbushin kriterin për sa i përket objektit të shitjeve, data dhe vlerat ku shumat në total janë $251,250 + 120,25 = 371,875$ L pa TVSh krahasuar me 20% të Fondit Limit $1,468,550 = 293,710$ L pa TVSh**, rezulton në përmbushje të kriterit 2.3.1, paragrafi i dytë (kriteri kualifikues sipërcituar).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon referuar fakteve, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, 2.3.1 kapaciteti teknik, në lidhje: ***Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;***

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për sa më sipër referuar, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, mbi parregullsi të dokumentacionit të operatorit ekonomik të kualifikuar i pari “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër në pikën III.2 e vijim të këtij Vendimi,

gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.5. Në lidhje me ankesën e operatorit “Inpress” SHPK, me nr. 167/2026 prot., datë 20.01.2026 me anë të së cilës kundërshton arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon: *Oferta rezulton me vlerë anomalisht të ulët. Me pretendimet:*

Oferta ekonomike e paraqitur nga OE “Inpress” SHPK., Nuk është anomalisht të ulët dhe si rrjedhojë, NUK do të duhej të skualifikohej dhe e vetmja mënyrë është kualifikimi i një prej tre operatorëve të skualifikuar atëherë oferta jonë nuk do të konsiderohet anomalisht e ulët.

Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Skualifikimin e Operatorëve Ekonomikë:

Infosoft Office shpk. Marketing & Distribution shpk dhe IT Gjergji Compiuter shpk. Janë skualifikuar pa të drejtë nga KVO.

Kërkojmë që AK dhe KPP do të duhet të:

- Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Albpetrol SH.A.;
- Kualifikojë njërin apo të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës: Infosoft Office SHPK. Marketing & Distribution SHPK dhe IT Gjergji Compiuter SHPK,
- Kualifikojë OE Inpress SHPK;
- ...si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik “Inpress” SHPK.

III.5.1. Komisioni në vijim të shqyrtimit më sipër gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues pranohet pjesërisht pasi, gjendja faktike dhe juridike operatorëve ekonomik do të ndryshojë pas ankimit në KPP dhe autoriteti kontraktor do të rivlerësojë ofertat dhe për rrjedhojë do të ri-aplikojë mënyrën e përlllogaritjes së ofetës anomalisht të ulët, sipas nenit 82 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar duke vlerësuar ofertën ekonomike të ofertuesit ankimues.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues pranohen pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK mbi arsyen e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.
 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar ofertën e operatorit “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK dhe kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi.
 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me këtë vendim.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Inpress” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

